



**BASHKIA  
TIRANË**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA TIRANË**

## URDHËR

Nr. 267/7, datë 10. 7. 2018

### PËR

### “NGRITJEN E KOMISIONIT TË APELIMEVE”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 113 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikës 2, të nenit 8 dhe në shkronjën b, të pikës 1.1, të paragrafit 1, të nenit 9, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”; ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë së Bashkisë dhe Të Komunës” (i ndryshuar); Urdhërit të Përbashkët Për Miratimin e Rregullores së Brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake e të Komunës; Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 687, datë 5.12.2013 “Për Mënyrën e Evidentimit dhe Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative, Procedurat që ndiqen për masat Administrative Plotësuese, Administrimi i Gjobave dhe Pasqyrat Statistikore në Fushën e Qarkullimit Rrugor” (i ndryshuar); Urdhëresës së Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 25850, datë 26.08.2016 “Për Rregullat dhe Kushtet e zënies së Hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës” (e ndryshuar); Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 33739, datë 07.11.2016 “Për Mënyrën e Evidentimit dhe Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative, në fushën e Qarkullimit Rrugor”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 10, datë 12.10.2011 “Për Krijimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës”; Vendimit nr. 3183, date 01.02.2016 të Kryetarit të Bashkisë “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë”; ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis” (i ndryshuar); Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” (i ndryshuar); Vendimit nr. 1, datë 05.02.2007 të Këshillit Bashkiak “Për Rregullimin e Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 37 datë 03.09.2015 “Për gjobat për dëmtime në rrjetin rrugor, rrjetin elektrik rrugor, dhe hapësirat e gjelbra të Bashkisë Tiranë dhe metoda e vlerësimit të dëmit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 11.04.2008 “Për Vendosjen e Gjobave për Shkeljet e Kryera nga Shoqëritë e Ndërtimit; Vendimit nr. 48, datë 11.11.2015

të Këshillit Bashkiak “Për Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 11.11.2015 “Për Miratimin e Kritereve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim, si dhe Tarifave të Shërbimit të Administruara nga Bashkia e Tiranës” (i ndryshuar); Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë;

## URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Apelimeve që do të ketë përbërjen si më poshtë vijon:

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit;	Kryetar
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike;	Anëtar
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.	Anëtar

2. Komisioni i ngritur sipas pikës 1 të këtij Urdhri, do të ketë për objekt shqyrtimin e ankimeve administrative, si më poshtë:

- Shqyrtimi i ankimeve administrative për gjobat e vendosura nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, në zbatim të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 1, datë 05.02.2007 “Për Rregullimin e Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 03.09.2015 “Për Gjobat për dëmtime në rrjetin rrugor, rrjetin elektrik rrugor, dhe hapësirat e gjelbra të Bashkisë Tiranë dhe metoda e vlerësimit të dëmit dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 11.04.2008 “Për Vendosjen e Gjobave për Shkeljet e Kryera nga Shoqëritë e Ndërtimit”;

- Shqyrtimi i ankimeve administrative për masat administrative të vendosura nga Policia Bashkiake deri në vlerën 5.000 lekë, në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake e të Komunës” (i ndryshuar);

- Shqyrtimi i ankimeve administrative për masat administrative të vendosura nga Tirana Parking, lidhur me qëndrimin përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 48, datë 11.11.2015 “Për Krijimin e



Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë” (i ndryshuar);

- Masat administrative të vendosura për shkelje të detyrimeve fiskale nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me inspektimin e shlyerjen e detyrimeve për pagesën e tarifës për zënien e hapësirës publike sipas Urdhëresës së Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 25850, datë 26.08.2016 “Për Rregullat dhe Kushtet e zënies së Hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës” (e ndryshuar).
3. Komisioni i Apelimeve pasi merr në shqyrtim ankimet administrative i sugjeron Kryetarit të Bashkisë zgjidhjen, si organi i vetëm që del me vendim, brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligj.
  4. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Tirana Parking, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, si dhe anëtarët e Komisionit të Apelimit.
  5. Pjesë e këtij urdhri do të jenë dhe procedurat që do të zbatohen për shqyrtimin e ankimeve administrative sipas Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
  6. Urdhri nr. 11064, datë 12.04.2016 i Kryetarit të Bashkisë “Për Ngritjen e Komisionit të Apelimit” shfuqizohet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Erion Veliaj**



## ANEKSI 1

Procedurat që duhet të ndiqen për shqyrtimin e ankimeve administrative, nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Tirana Parking, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Ankimimeve janë:

1. Subjekti pasi merr dijeni për aktin administrativ, ka të drejtën brenda afatit 30 ditor, nga momenti i marrjes dijeni, të paraqesë ankimin administrativ drejtuar Kryetarit të Bashkisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, në Bashkinë e Tiranës, ose nëpërmjet shërbimit postar. Ankimi duhet të ketë bashkëngjitur aktin administrativ që subjekti kundërshton. Subjektet ankimues duhet të informohen (kur është e mundur), se përgjigjja për ankimin e kryer do të merret në vendin ku kanë kryer ankimin administrativ si dhe këto vendime duhet të shpallen në stendat për informim të qytetarëve pranë Bashkisë së Tiranës.
2. Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë nuk duhet të pranojë ankimet e subjekteve për gjoba në zbatim të vendimit nr. 13, datë 15. 01. 2010 të Këshillit Bashkiak "Për Vendosjen e Gjobave në Vend Ndaj Subjekteve, për Shkeljet e Kryera në Fushën e Transportit Rrugor», pasi janë gjoba në vend.
3. Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Arkivit Qendror dhe Protokollit, duhet që brenda 5 ditëve, nga data e depozitimit të ankimit administrativ t'u dërgojnë ankimin administrativ Drejtorisë përkatëse, akti i së cilës kundërshtohet në ankimin administrativ, kjo procedurë vlen dhe për ankimet administrative të cilat janë kryer në formë elektronike.
4. Drejtoria përkatëse pasi merr ankimin, ka detyrimin që të plotësojë dosjen e subjektit ankimues me aktet dhe provat që disponon, duke përfshirë këtu akte shkresore, foto ose çdo dokumentacion tjetër që ka lidhje me ankimin e kryer, procedurën e ndjekur dhe masën administrative të vendosur si dhe të shprehet me një qëndrim në lidhje me konstatimin e kundërvatjes administrative dhe marrjen e masës ndëshkuese. Ky informacion duhet të përcillet pranë Bashkisë së Tiranës, Drejtorisë së Përgjithshme të Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Ankimimeve brenda një afati 10 ditor nga data e marrjes në dorëzim të ankimit administrativ.
5. Sektori i Ankimit Administrativ në Drejtorinë e Ankimimeve, pasi merr dosjen e plotësuar, brenda 5 ditëve duhet të marrë në shqyrtim ankimin dhe t'ia dërgojë për shqyrtim Komisionit të Apelimeve i cili duhet të mbledhet të paktën një herë në 10 ditë.



6. Gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ mbahet procesverbali i mbledhjes nga specialistë të Sektorit të Ankimit Administrativ ku evidentohet i gjithë informacioni i administruar në dosjen e ankimit dhe në përfundim të shqyrtimit Komisioni i Apelimeve del me një mendim sugjerues për zgjidhjen e ankimit drejtuar Kryetarit të Bashkisë, si organ i vetëm vendim marrës. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Apelimeve dhe i dërgohet Kryetarit të Bashkisë për miratim.
7. Pas miratimit të Kryetarit të Bashkisë, procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Apelimeve përcillet pranë Sektorit të Ankimit Administrativ për të përgatitur vendimet e Kryetarit të Bashkisë, për ankimin administrativ të paraqitur. Vendimet përgatiten në 4 kopje. Një kopje e vendimit dërgohet për njoftim subjektit ankimues, një kopje i dërgohet Drejtorisë që ka nxjerrë aktin administrativ të kundërshtuar në ankim, një kopje mbahet në dosjen e administruar nga Sektori i Ankimit Administrativ së bashku me praktikën përkatëse, dhe kopja e katërt lihet për arkivim pranë Drejtorisë së Arkivit Qendror dhe Protokollit. Një fotokopje e vendimit dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë për të bërë shpalljen e vendimit. Në çdo rast subjekti merr dijeni për vendimin e Kryetarit të Bashkisë në vendin në të cilin subjekti ka depozituar ankimin administrativ (në rastin e ankimit me anë të shërbimit postar, vendimi i Kryetarit të Bashkisë do ti njoftohet ankimuesit po me anë të shërbimit postar, në adresën e deklaruar nga vetë ankimuesi).
8. Kundër vendimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ankimuesi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve, nga data e marrjes dijeni të aktit.